

REZOLUTË
Nr.2, datë 17.4.1998

Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë i mbledhur në seancë plenare për shqyrtimin e përkeqësimit të mëtejshëm të krizës në Kosovë dhe pasojave që mund të sjellë kjo për stabilitetin e gjithë rajonit:

vëren se represioni dhe dhuna e forcave ushtarake e policore serbe kundër shqiptarëve në Kosovë po vazhdon edhe pas deklaratës së Grupit të Kontaktit të datës 25.3.1998, duke e bërë gjendjen edhe më të rrezikshme;

vlerëson iniciativën e komunitetit ndërkombëtar për zgjidhjen e shpejtë dhe afatgjatë të problemit të Kosovës, por në të njëjtën kohë;

vëren se afati i dhënë Milosheviçit nga Grupi i Kontaktit, po i shërben atij për dislokimin e mëtejshëm të trupave me qëllim ushtrimin e dhunës dhe spastrimin etnik të popullsisë shqiptare të Kosovës;

e quan vendosjen e mbajtjes së referendumit për pjesëmarrjen ose jo të palës së tretë në bisedimet midis autoriteteve federative të FRJ-së dhe autoriteteve shqiptare të Kosovës si kundërshtim të hapur të kërkesës për bisedime dhe si sfidë brutale ndaj rekomandimeve të komunitetit ndërkombëtar;

e sheh si provokacion të hapur ndaj Republikës së Shqipërisë lëvizjen e trupave serbe në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë;

i bën thirrje OKB-së, strukturave politike europiane dhe Kongresit Amerikan për rivlerësimin e situatës në Kosovë dhe marrjen e masave efektive;

kërkon si hap të parë vendosjen e trupave të NATO-s në territorin e Kosovës për evitimin e zgjerimit të konfliktit dhe si garanci për mosushtrimin e dhunës ushtarake ndaj popullsisë civile të pambrojtur;

i bën thirrje Presidentit të SHBA, Bill Clinton, që të imponojë vijën e kuqe amerikane në Kosovë;

mbështet pa rezerva të drejtën e vetëvendosjes politike të popullit të Kosovës, e drejtë që u njihet gjithë popujve nga kartat ndërkombëtare dhe e zbatuar kohët e fundit për shumë vende të rajonit;

nxit Qeverinë për përpunimin e një plani konkret për arritjen e sa më sipër dhe marrjen e masave energjike për mbrojtjen kombëtare dhe rendin publik;

u bën thirrje të gjitha forcave politike për urtësi e qëndrim të përbashkët për çështjen e Kosovës, zgjidhja e së cilës është dhe kyçi i zgjidhjes së çështjes kombëtare në tërësi.

Kjo Rezolutë t'u dërgohet edhe gjithë parlamenteve të vendeve pjesëmarrëse në OSBE.